



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Mars 2021

Nr: 146

VENDIM

PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2, dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, dhe relacionin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92, shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Me vendimin nr. 69, datë 15.02.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 dhe 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Partia Socialiste e Shqipërisë, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore më datë 8.3.2021.



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 130, datë 10.03.2021, vendosi kthimin për korrigjimin e dokumentacionit, të listës shumemërore të kandidatëve për deputet të subjektit zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Brenda afatit ligjor subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë ridepozitoi dokumentacionin e korrigjuar.

Dokumentacioni i paraqitur përmban:

1. Listat shumemërore për 12 Zonat Zgjedhore; Model - 03
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën e votës dhe se pranojnë të kandidojnë si kandidat të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë; Model – 05;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore Model – 07;
5. Vërtetimin nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili vërteton se Partia Socialiste e Shqipërisë, zotëron mandat në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë;
6. Formularët e vetëdeklarimit për të gjithë kandidatët, në zbatim të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
7. Deklaratën Model 03/1 për disa kandidatë të cilët kanë planifikuar marrjen/ pranimit donacione

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit, nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për deputet, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për deputetë, rezulton se përveç kandidateve të poshtëpërmendur, të gjithë kandidatët e tjerë nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

1. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Klajdi Selim Qama, kandidat për deputet, qarku Berat, me numër rendor 8, rezulton se ka deklaruar :



- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të formularit të vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitetet e tij dhe është shprehur se, ka ndryshuar datëlindjen nga “02.06.1988” në “13.06.1988”.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, **pikës 1**, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

“Me vendimin nr. 70 datë 24.03.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, e ka dënuar për kundërvajtjen penale, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur masa e dënimit me gjobë 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë”.

2. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ylli Vesel Shehu, kandidat për deputet, qarku Tiranë, me numër rendor 24, rezulton se ka deklaruar :
 - Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të formularit të vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitetet e tij dhe është shprehur se, ka ndryshuar mbiemrin nga “Lala” në “Shehu”.
 - Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “A keni jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Me vendimin nr. 420 datë 27.03.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka dënuar për veprën penale, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur masa e dënimit me gjobë.
- Me vendimin nr. 44 datë 18.11.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e ka dënuar për veprën penale, parashikuar nga neni 186/1 dhe 190/1 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur masa e dënimit me gjobë.

Pikës 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, është përgjigjur me “Po”, duke deklaruar se, ka jetuar në Kanada, për arsye COVID -19, për periudhën 03.03.2020 deri më 01.05.2020.

3. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. **Spartak Ibrahim Braho**, kandidat për deputet, qarku Tiranë, me numër rendor 28, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të formularit të vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitetet e tij dhe është shprehur se, ka ndryshuar emrin nga “Zylyftar” në “Spartak”.



Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “A keni jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 1397 datë 22.12.1995, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale “Shpifje”, parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur masa e dënimit 10.000 (dhjetë mijë) lekë gjobë.

Me vendimin nr. 239 datë 03.02.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale “Fyerje dhe Shpifje”, parashikuar nga neni 119/2, 119/A dhe 120/2 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur pushim i çështjes.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja “b” dhe paragrafi 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresat nr. 1987 prot., datë 12.03.2021 dhe nr. 2084 prot., datë 16.03.2021 (shkresë e dërguar për shkak të ndryshimit të gjenealiteteve të kandidatëve) ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresat nr. 1988 prot., datë 12.03.2021 dhe nr. 2085 datë 16.03.2021 (shkresë e dërguar për shkak të ndryshimit të gjenealiteteve të kandidatëve) ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresat nr. 2689/1 prot., datë 12.03.2021 dhe 2727/1 prot., datë 16.03.2021 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për deputetë, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas të cilës rezulton si vijon:

1. **Qarku Berat, z. Klajdi Selim Qama, me numër rendor 8,** në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 11 prot., datë 12.03.2021, në bazë të vendimit nr. 70 datë 24.03.2010, Gjykata e Rrethit Berat, e deklaron fajtor për veprën penale të “Kanosjes”, parashikuar nga neni 84 K.P, dhe e dënon me 120.000 (një qind e njëzetë mijë) lekë gjobë.

Në aplikim të nenit 406 K.Pr.P e dënon përfundimisht me 80 (tetëdhjetë) mijë lekë gjobë.

Rehabilituar neni 69/A i Kodit Penal.

Referuar deklaramëve të kandidatit dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi me gjobë sipas parashikimeve të nenit 84 i Kodit Penal, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të



nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë.

2. **Qarku Tiranë, z. Ylli Vesel Shehu, me numër rendor 24**, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 11 prot., datë 12.03.2021,

- Me vendimin nr. 420 datë 20.03.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e deklaroi fajtor për veprën penale “Kontrabandë me mallra të tjerë”, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal dhe neni 406 K.Pr.P dënohet me 200.000 (dy qind mijë) lekë gjobë.
- Me vendimin nr. 41-2008-3047 datë 18.11.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 174, 186/1, 190/2, 55 K.P dhe dënohet me 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë gjobë.

Referuar deklaramëve të kandidatit dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi me gjobë sipas parashikimeve të nenit 174, 186/1, 190/2, 55 të Kodit Penal, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë.

3. **Qarku Tiranë, z. Spartak Ibrahim Braho, me numër rendor 28**, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 11 prot., datë 12.03.2021,

- Me vendimin nr. 1397 datë 22.12.1995, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale “Shpifje e bërë botërisht”, parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal dhe e dënon me 10.000 (dhjetë mijë) lekë gjobë.

Në bazë të nenit 69 të Kodit Penal është rehabilituar dhe quhet i padënuar.

- Me vendimin nr. 239 datë 03.02.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka pushuar çështjen penale ndaj të pandehurit të mësipërm akuzuar për veprën penale të “Fyerjes” dhe “Shpifjes” bazuar në nenet 119/2, 119/A dhe 120/2 të Kodit Penal.

Referuar deklaramëve të kandidatit dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi me gjobë sipas parashikimeve të nenit 120/2 i Kodit Penal, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë.

Kandidatët e tjerë të listës shumëmemërore, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, rezultojnë të jenë të padënuar.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për deputet, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar ligjit, nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose shtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për



përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kandidatët për deputetë, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për Zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe në shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për zonat zgjedhore, Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Qarku Fier, Qarku Gjirokastrë, Qarku Korçë, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Lista shumemërore

Partia Socialiste e Shqiperise

Qarku Berat

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Hatixhe	Kamber	Konomi	03/02/1978	F
2	Bardhyl	Myrteza	Kollçaku	05/06/1967	M
3	Fadil	Ramo	Nasufi	18/03/1958	M
4	Nasip	Qani	Naço	05/04/1961	M
5	Blendi	Pëllumb	Klosi	17/01/1971	M
6	Sara	Leonard	Satka	12/08/1998	F
7	Jurgen	Dhimiter	Pushi	05/07/1989	M
8	Klajdi	Selim	Qama	13/06/1988	M
9	Rabushe	Flamur	Hoxha	03/01/1989	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9

Partia Socialiste e Shqiperise

Qarku Dibër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Lavdrim	Mersin	Krrashi	05/09/1969	M
2	Aurora	Xhavit	Mara	11/06/1978	F
3	Dionis	Xhelil	Imeraj	07/12/1983	M
4	Melaim	Zyber	Damzi	02/09/1967	M
5	Spartak	Femi	Koltraka	16/06/1984	M
6	Anisa	Bardhul	Xhika	14/02/1986	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Partia Socialiste e Shqiperise

Qarku Durrës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Milva	Vilson	Ekonomi	31/12/1962	F
2	Alban	Viktor	Xhelili	23/08/1972	M
3	Jurgis	Shefqet	Çyrbja	15/07/1985	M
4	Klodiana	Fatmir	Spahiu	22/05/1973	F
5	Ilir	Muhamed	Ndraxhi	28/01/1964	M
6	Rrahman	Rexhep	Rraja	07/04/1961	M
7	Lefter	Haki	Koka	04/08/1964	M
8	Edi	Kristaq	Rama	04/07/1964	M
9	Ana	Vladimir	Dhamo	02/09/1985	F
10	Artan	Nazmi	Bitri	02/10/1975	M
11	Keida	Ramazan	Bejaj	20/12/1974	F
12	Arkend	Bashkim	Balla	26/06/1985	M
13	Denis	Mehmet	Deliu	17/05/1986	M
14	Klementina	Kadri	Meçi	15/10/1991	F
15	Erjon	Shërbet	Meka	08/05/1977	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor **15**

Partia Socialiste e Shqiperise

Qarku Elbasan

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Evis	Kolë	Kushi	07/10/1975	F
2	Klevis	Harilla	Xhoxhi	30/11/1978	M
3	Besion	Gëzim	Ajazi	05/07/1985	M
4	Dasantila	Mensur	Tahiraj	18/10/1972	F
5	Saimir	Shpend	Hasalla	09/01/1987	M
6	Florenc	Fatmir	Spaho	09/06/1984	M
7	Luan	Xhemal	Duzha	25/11/1966	M
8	Taulant	Kasem	Balla	12/08/1977	M
9	Albana	Xhevat	Hana	01/10/1980	F
10	Enver	Mersin	Roshi	04/06/1961	M
11	Briseida	Lavdi	Gjoza	01/08/1988	F
12	Shkëlqim	Shefqet	Bullari	26/04/1969	M
13	Marsida	Sadush	Hyseni	23/08/1985	F
14	Endri	Muin	Pepa	27/06/1992	M
15	Kristaq	Dhimiter	Skenderi	21/05/1968	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor **15**



Lista shumemërore

Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Fier

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Erion	Mirdash	Braçe	02/04/1972	M
2	Petro	Vasil	Koçi	15/02/1961	M
3	Lindita	Izet	Buxheli	03/08/1966	F
4	Bashkim	Muhamet	Fino	12/10/1962	M
5	Baftjar	Mehmet	Zeçaj	15/02/1961	M
6	Antoneta	Nasi	Dhima	05/12/1970	F
7	Bujar	Avdulla	Çela	14/05/1960	M
8	Ismet	Shyqyri	Beqiraj	10/05/1958	M
9	Tatiana	Nuredin	Piro	20/06/1958	F
10	Gramoz	Kaso	Ruçi	06/12/1951	M
11	Robert	Thoma	Bitri	10/03/1958	M
12	Mirela	Llambro	Pitushi	16/08/1974	F
13	Arbër	Behar	Arapi	08/06/1986	M
14	Sokol	Haxhi	Krasniqi	08/12/1989	M
15	Ëriola	Ushtar	Hoxha	01/08/1987	F
16	Ergest	Pëllumb	Krakulli	22/05/1980	M
17	Adela	Vladimir	Hysenaj	14/06/1991	F
18	Nimet	Aqif	Musaj	29/01/1960	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 18

Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Gjirokastrë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Mirela	Mentar	Kumbaro (Furxhi)	04/03/1966	F
2	Laert	Seit	Duraj	10/11/1972	M
3	Bledar	Triumf	Çuçi	14/11/1970	M
4	Artemis	Kosta	Malo	19/05/1981	F
5	Kosta	Thoma	Garo	21/05/1976	M
6	Kjara	Themistokli	Adhami	15/10/1994	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Partia Socialiste e Shqiperise

Qarku Korçë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Enslemvera	Vehbi	Zake	12/02/1981	F
2	Blerina	Guri	Gjylameti	23/01/1980	F
3	Ilirian	Anesti	Pendavinji	16/05/1971	M
4	Ilir	Osman	Topi	01/10/1970	M
5	Olta	Anxhelo	Xhaçka	25/12/1979	F
6	Niko	Aleks	Peleshi	11/11/1970	M
7	Edlira	Përparim	Bode	19/04/1973	F
8	Bledi	Dhimitraq	Çomo	22/06/1982	M
9	Besa	Gezim	Spaho	03/12/1987	F
10	Dhora	Thanas	Shkempi	25/03/1994	F
11	Arian	Nasibi	Jaupllari	22/05/1960	M
12	Vasil	Kërstin	Sterjovski	17/05/1982	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12

Partia Socialiste e Shqiperise

Qarku Kukës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Gerta	Shyqyri	Duraku	29/06/1984	F
2	Petrit	Nuredin	Malaj	12/12/1961	M
3	Halim	Ismail	Dauti	27/04/1989	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 3

Partia Socialiste e Shqiperise

Qarku Lezhë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Lindita	Llesh	Nikolla	22/10/1965	F
2	Eduard	Ndue	Ndreca	11/02/1983	M
3	Shpresa	Ndue	Marnoj	05/03/1984	F
4	Gentian	Mirash	Malotaj	17/06/1991	M
5	Benard	Pal	Palaj	11/04/1988	M
6	Eueda	Fatmir	Molla	15/05/1993	F
7	Erjola	Llesh	Ndoci	30/08/1992	F
8	Gjon	Pjetër	Ndoci	06/01/1992	M
9	Lina	Nik	Guri	14/09/1972	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9



Lista shumemërore

Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Shkodër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Edona	Xhavid	Bilali	13/06/1989	F
2	Paulin	Nikollë	Sterkaj	05/07/1961	M
3	Benet	Bahri	Beci	25/01/1965	M
4	Ilir	Hamit	Beqaj	18/02/1968	M
5	Frrok	Gjin	Gjini	06/09/1960	M
6	Lela	Selami	Berdica	06/03/1997	F
7	Pal	Prek	Peraj	01/05/1969	M
8	Kristian	Luigj	Shkreli	21/11/1986	M
9	Diana	Eqerem	Muriqi	03/07/1963	F
10	Jona	Gjergj	Leqeja	02/10/1987	F
11	Alda	Ded	Mema	04/10/1995	F
12	Kabir	Sait	Fishta	04/10/1995	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

12



Lista shumemërore

Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Tiranë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Luljeta	Vasil	Bozo	02/10/1942	F
2	Najada	Fatosh	Çomo	21/11/1961	F
3	Ervin	Alfred	Bushati	15/10/1975	M
4	Ogerta	Dhionis	Manastirliu	31/12/1978	F
5	Arben	Nevruz	Ahmetaj	28/06/1969	M
6	Ulsi	Qerim	Manja	05/10/1973	M
7	Etilda	Dalip	Gjonaj	06/05/1981	F
8	Arben	Servet	Pëllumbi	22/09/1965	M
9	Elisa	Aleksander	Spiropali	15/03/1983	F
10	Belinda	Çlirim	Balluku	09/10/1973	F
11	Toni	Jorgaq	Gogu	24/07/1972	M
12	Etjen	Vullnet	Xhafaj	06/04/1982	M
13	Ermonela	Koço	Valikaj	09/11/1976	F
14	Xhemal	Myslym	Qefalia	27/02/1963	M
15	Fidel	Bahri	Ylli	01/09/1962	M
16	Klotilda	Fatmir	Bushka	11/04/1979	F
17	Alqi	Edmond	Billako	10/05/1987	M
18	Eduard	Pajtim	Shalsi	01/04/1968	M
19	Pandeli	Sotir	Majko	15/11/1967	M
20	Plarent	Pjetër	Ndreca	27/05/1977	M
21	Mimi	Pjetër	Kodheli	11/09/1964	F
22	Dallëndyshe	Agim	Bici	30/04/1978	F
23	Fatmir	Sezai	Xhafaj	17/05/1959	M
24	Ylli	Vesel	Shehu	24/02/1981	M
25	Alfred	Albert	Muharemi	18/02/1991	M
26	Romina	Argjir	Kuko	19/04/1984	F
27	Edmond	Abaz	Rrushi	17/10/1969	M
28	Spartak	Ibrahim	Braho	17/07/1951	M
29	Klodeta	Shuaip	Dibra	15/01/1966	F
30	Ornaldo	Aqif	Rakipi	29/01/1994	M
31	Bora	Kastriot	Muzhaqi	11/03/1990	F
32	Eljo	Kastriot	Hysko	29/01/1993	M
33	Vahid	Fadil	Shaba	21/07/1963	M
34	Kledina	Fatmir	Skëndo	26/02/1992	F
35	Halit	Xhezar	Valteri	21/05/1991	M
36	Tahir	Abdulla	Muhedini	19/04/1954	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

36



Lista shumemërore

Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Vlorë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Pranvera	Neki	Resulaj	30/03/1974	F
2	Anduel	Durmish	Tahiraj	23/12/1984	M
3	Vullnet	Ruzhdi	Sinaj	24/08/1965	M
4	Anila	Spiro	Denaj	18/09/1973	F
5	Niko	Foto	Kuri	27/10/1968	M
6	Ilir	Sherif	Metaj	01/12/1973	M
7	Damian	Lekë	Gjikhuri	25/05/1972	M
8	Edi	Kristaq	Rama	04/07/1964	M
9	Teuta	Barjam	Ramaj	25/12/1982	F
10	Ervis	Vasil	Moçka	09/03/1981	M
11	Leonard	Veli	Beqiri	08/04/1966	M
12	Laura	Viron	Ferati	10/10/1988	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12Subjekti Zgjedhor ka: 153 kandidatë